

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Reemat Premium

PËLHURË PËRFORCIMI PREJ FIBRASH QELQI PËR SISTEMET E MEMBRANAVE TË LËNGSHME SIKALASTIC®



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Reemat Premium është rrjetë përforcuese e përbërë nga fibra qelqi për sistemet e membranave të lëngshme Sikalastic®.

PËRDORIMET

- Përforcim për sistemet Sikalastic® dhe SikaRoof® MTC
- Përforcim për SikaRoof® MTC Detailing
- Për projekte të reja ndërtimi dhe rikonstruksioni
- Për çati / tarraca me shumë detaje dhe gjeometri të ndërlikuar edhe kur aksesueshmëria është e kufizuar

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i thjeshtë dhe i shpejtë
- Përshtatet lehtë në detajet e ndërlikuara
- Siguron trashësinë e saktë të shtresës së parë bazë
- Përmirëson vetitë e sistemit për ngushtimin e plasaritjeve
- Përforcon vetitë mekanike të sistemit

MIRATIME / STANDARDE

Përbërës sistemi me miratimet e mëposhtme të ETAG 005:

- ETA - 09/0139
- ETA - 12/0316
- ETA - 13/0456
- ETA - 14/0177

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Fibra qelqi me shpërndarje dhe thurje të rastësishme
Ambalazhi	Rulona: <ul style="list-style-type: none"> ▪ gjerësi 1.3 m dhe gjatësi 150 m ▪ gjerësi 1.3 m dhe gjatësi 90 m ▪ gjerësi 0.3 m dhe gjatësi 150 m
Paraqitja / Ngjyra	E bardhë
Jetëgjatësia	Produkti nuk skadon nëse ruhet saktë
Kushtet e magazinimit	Produkt duhet të magazinohet saktë në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në pozicion horizontal dhe pa formuar palosje, në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +35 °C.
Masa për njësi sipërfaqeje	225 g/m ²

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit Për informacione të detajuara rreth ndërtimit të sistemit, ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit ose membranës së lëngshme.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme, me rezistencë të mjaftueshme, e pastër, e thatë dhe pa pislleqe, vaj, graso dhe kontaminime të tjera. Lyerja me prajmer ose pastrimi mekanik duhet bërë në varësi të materialit të nënshtresës. Për nivelimin e sipërfaqes mund të jetë e nevojshme bluarja. Nënshtresat e përshtatshme janë: betoni, membranat dhe veshjet bituminoze, metalet, tullat, çimento asbesti, pllakat qeramike, druri.

Për informacione të detajuara në lidhje me përgatitjen e sipërfaqes dhe tabelës së prajmerave ju lutemi referohuni tek Method Statement të sistemit korrespondues të membranës së lëngshme.

APLIKIMI

Përpara aplikimit të Sikalastic® shtresa e prajmerit duhet të jetë tharë e të mos ngjisë. Për Kohën e pritjes / Mbiveshjen, ju lutemi referohuni në skedën teknike të prajmerit të duhur. Zonat e dëmtueshme (pamakë etj.) duhet të mbrohen me shirit ose mbështjellëse plastike.

Sika® Reemat Premium aplikohet në kombinim me sistemet e membranave të lëngshme Sikalastic®.

1. Aplikoni veshjen e parë të membranës së lëngshme Sikalastic® me shkallë konsumimi sipas skedës teknike të saj. Punoni deri në pikën ku materiali mbetet i lëngët.
2. Kaloni rulin mbi Sika® Reemat Premium dhe sigurohuni se nuk ka flluska apo palosje. Mbivendosja e Sika® Reemat Premium duhet të jetë min. 5 cm dhe sigurohuni se mbivendosjet janë mjaftueshëm të lagura për t' u ngjitur.
3. Ruli mund kërkojë vetëm pak material shtesë për të qëndruar i lagur, por nuk nevojitet shtim material në këtë fazë.
4. Pasi veshja të jetë tharë mjaftueshëm që të mund të shkelet, izoloni zonën e tarracës / çatisë me veshje të dytë nga membrana e lëngshme Sikalastic® me shkallë konsumimi sipas skedës teknike të membranës së lëngshme.

Ju lutemi vini re, filloni gjithmonë me detajet përpara hidroizolimit të sipërfaqes horizontale. Për hollësi ndiqni hapat 1–3.

Për informacione të detajuara aplikimi ju lutemi referohuni tek Method Statement e sistemit përkatës së membranës së lëngshme.

KUFIZIME

Kufizimet diktohen nga lëngu individual Sikalastic® që do të përdoret – Ju lutemi këshillohuni skedën teknike përkatëse.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidate të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® Reemat Premium
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020915952000000004

SikaReematPremium-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf